


Ndërlidhja e premtimeve zgjedhore me treguesit e performancës komunale



Prill 2025



Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige

— Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
Përmbledhje ekzekutive	4
Hyrje	5
Metodologjia, qëllimi dhe shtrirja e studimit	6
Specifikat dhe fushat e premtimeve zgjedhore dhe performancës komunale	6
A korrespondojnë premtimet zgjedhore me treguesit e performancës komunale	14
Përfundim	22

Ndërlidhja e premtimeve
zgjedhore me treguesit
e performancës komunale
(Analizë në 15 komuna)

Prill 2025

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra dhe Suedia përmes projektit DEMOS, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Helvetas Swiss Intercooperation, Bashkimit Evropian, Zvicrës dhe Suedisë.

©DEMOS Publikuar: Prill 2025, Prishtinë, Kosovë.

Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DEMOS	Projekti për Decentralizimin dhe Përkrahje Komunave
GPK	Granti i Performancës Komunale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
SMPK	Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Përmbledhje ekzekutive

Premtimet zgjedhore të kryetarëve të komunave të Kosovës dhe Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK), i menaxhuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), paraqesin dy procese të ndryshme, por të ndërlidhura në qeverisjen lokale, megjithëse dallojnë në qasje dhe përmbajtje. Të dy këto procese janë mekanizma të rëndësishëm në vlerësimin e efikasitetit të qeverisjes lokale.

Raportimi i komunave në SMPK është një proces i detyrueshëm, i bazuar në ligj, dhe ka mekanizma të ndërtuara që merren me menaxhimin, vlerësimin dhe raportimin e të dhënave që bëjnë komunitat. Në anën tjetër, premtimet janë një zgjedhje e lirë e kandidatëve për kryetarë të komunave varësisht se në cilat fusha, projekte ose probleme mendojnë se është më mirë të fokusohen. Kandidatët për kryetarë të komunave në Kosovë nuk janë të obliguar ligjërisht të japin premtime zgjedhore. Nga ana tjetër, nuk ekziston monitorim institucional për të vlerësuar nëse premtimet e dhëna po përmbushen apo jo, siç është rasti me treguesit e SMPK që vlerësohen nga MAPL. Këto nuk janë dallimet e vetme meqë, për dallim nga SMPK i cili ofron një qasje sistematike dhe të matshme të performancës komunale dhe përmes së cilit komunitat shpërblehen ose nuk përfitojnë grant të performancës, premtimet zgjedhore shpesh janë më gjithëpërfshirëse dhe nuk ekziston ndonjë shpërblim apo ndëshkim për përmbushjen apo mospërmbushjen e tyre; përjashtimisht efekteve në perceptimin e opinionit publik.

Nga krahasimi dhe vlerësimi i komunave, pjesë të këtij raporti, rezulton se nga 800 premtime sa janë dhënë në 14 komunitat e fokusuar në këtë raport, 166 apo 21% prej tyre kanë lidhje të plotë ose të pjesshme me treguesit e SMPK, ndërsa 634 apo 79% e premtimeve nuk ndërlidhen në asnjë formë me treguesit e sistemit të menaxhimit të performancës komunale.

Tri komunitat që kanë ndërlidhjen më të mirë mes premtimeve dhe SMPK janë: Prizreni, Obiliqi dhe Suhareka. Ndërsa tri komunitat që kanë lidhjen më të dobët janë: Vitia, Klina dhe Drenasi. Ndërlidhja mes premtimeve dhe treguesve dhe ndikimi i tyre te granti i performancës, jep rezultate të ndryshme te komunitat e ndryshme.

Nga 94 tregues gjithsej në SMPK, 35 prej tyre nuk hasen në asnjë premtim zgjedhor. Kjo ndodh për disa arsye, por kryesisht dominon shkaku se shumica e këtyre treguesve lidhen me procese administrative dhe teknike të menaxhimit komunal, të cilat nuk konsiderohen si "tërheqëse" nga perspektiva e fushatës zgjedhore dhe që do të rrisnin gjasat për marrjen e më shumë votave. Kandidatët për kryetarë të komunave, në vend të premtimeve rreth proceseve të brendshme administrative, zakonisht preferojnë të fokusohen në premtime më të prekshme dhe të dukshme si ndërtimi i rrugëve të reja apo rritja/dhënia e subvencioneve.

Treguesit në SMPK janë të ndarë në 16 fusha, ndërsa premtimet zgjedhore në 11 fusha. Si fusha që ndërlidhen mes SMPK dhe premtimeve janë administrata, kultura, infrastruktura, shërbimet publike, arsimit parauniversitar, shëndetësia dhe ekonomia. Lidhja mes fushave nuk nënkupton domosdoshmërisht edhe lidhje në të njëjtën fushë mes treguesve dhe premtimeve. Përderisa në SMPK ekziston fusha "Shërbime administrative", te premtimet zgjedhore kjo evidentohet si "Administratë". Te SMPK janë treguesit si kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit ose kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore, përderisa te premtimet zgjedhore janë premtimet si rritja e numrit të inspektorëve komunal, themelimi i drejtorive të reja, reforma në administratë, eliminimi i burokracive, etj.

Hyrje

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) në Kosovë përfaqëson një mekanizëm themelor për të përmirësuar jetën e qytetarëve dhe rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimeve publike në nivel lokal. Ky sistem, i cili ekziston në kuadër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), mat performancën komunale përmes treguesve specifikë në fusha të ndryshme, duke përfshirë shërbimet administrative, sociale, kulturore dhe infrastrukturore. Veçoritë kryesore të SMPK-së janë: vlerësimi i performancës së komunave, përdorimi i treguesve të matshëm dhe të verifikueshëm, ofrimi i krahasueshmërisë mes komunave dhe vlerësimi profesional i punës së komunave.¹

Ky sistem nisi fillimisht në vitin 2008 me iniciativën dhe mbështetjen e USAID-it. Fillimisht kishte vështirësi dhe paqartësi edhe për formën e raportimit, por edhe procesi i vlerësimit dhe verifikimit të dhënave kishte mangësitë e saj. Për të mundur që ky proces të bëhet sa më i rregullt dhe i saktë, në vitin 2015/16 është hartuar rregullorja specifike që e trajton dhe e rregullon këtë proces, për të vazhduar pastaj në vitin 2022 me miratimin e Ligjit për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë.² Bazuar në këtë ligj, procesi i performancës komunale nxjerr dy detyrime: për komunat që duhet të raportojnë në MAPL lidhur me rezultatet që kanë pasur në treguesit specifikë të performancës dhe për Qeverinë e Kosovës, e cila duhet të ndajë mjete specifike financiare për të mbuluar grantin bazuar në performancë.

Që nga viti 2011, sistemi i menaxhimit të performancës komunale ka kaluar nëpër disa faza zhvillimi. Fillimisht, vlerësimi përfshinte 12 fusha, të cilat u zgjeruan në 19. Megjithatë, në vitin 2023, ky numër u reduktua në 16 fusha. Metodologjia e vlerësimit dhe verifikimit të të dhënave është përmirësuar, lidhja mes performancës dhe financimit është forcuar si dhe është rritur edhe aftësia e komunave për të kuptuar dhe zbatuar sistemin.

Nga ana tjetër, që nga viti 2013, premtimet zgjedhore kanë ardhur duke u rritur në numër dhe duke u ndryshuar për nga natyra e tyre. Premtimet zgjedhore të kryetarëve të komunave përqendrohen në projekte infrastrukturore dhe investime në fushat si bujqësia, ekonomia, shëndetësia, arsimiti, urbanizimi, administrata e të tjera. Në mandatin 2013–2017 kanë qenë gjithsej 553 premtime të dhëna nga 27 kryetarë të komunave, përderisa në mandatin 2017–2021 ky numër është rritur për më shumë se 400, ndërsa në mandatin aktual 2021–2025 numri i premtimeve nga 27 kryetarë komunash ka arritur në 1816 premtime.³ Këto premtime janë të ndara në 11 fusha: infrastrukturë, shërbime publike, arsim, shëndetësi, bujqësi, kulturë, sport, sociale, urbanizëm, ekonomi dhe administratë.

1 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. [Raporti i performances komunale](#). 2022.

2 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligj për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë](#).

3 Instituti GAP. Letërnjoftimi i Komunave. [Premtimet](#).

Metodologjia dhe qëllimi

Rezultatet dhe të dhënat në këtë raport janë nxjerrë bazuar në dy burime kryesore, në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe në të gjithë treguesit e saj, si dhe në platformën "Letërnjoftimi i Komunave" të Institutit GAP, ku janë të listuara të gjitha premtimet e kryetarëve të komunave dhe ecuria e përmbushjes së tyre nga viti 2013 e tutje.

Raporti mbështetet edhe në burime alternative si Ligji për performancë komunale dhe grant bazuar në performancë, Ligji për vetëqeverisje lokale dhe po ashtu në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

Ecuria e përmbushjes së premtimeve zgjedhore ende nuk është përfundimtare, ngase pritet të bëhet edhe një përditësim i radhës nga Instituti GAP në gusht 2025. Rezultatet më të fundit të kësaj natyre të përdorura në këtë raport janë të dhëna nga qershori i vitit 2024.

Ky raport ka për qëllim të tregojë nëse ekziston lidhje ndërmjet premtimeve zgjedhore të kryetarëve të komunave dhe treguesve të sistemit të performancës komunale që është ndërtuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, që bën vlerësimin e komunave mbi baza vjetore dhe ndan grant bazuar në performancë për komunat.

Raporti fokusohet në 15 komuna të Kosovës: Drenas, Kaçanik, Pejë, Kamenicë, Obiliq, Graçanicë, Suharekë, Rahovec, Klinë, Viti, Dragash, Junik, Ferizaj, Podujevë dhe Prizren. Në shumicën e rasteve në këtë raport, Graçanica është përjashtuar pasi në këtë komunë nuk është listuar asnjë premtim i dhënë zgjedhor në zgjedhjet lokale të 2021. Bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë të publikuara në vitin 2024, në këto komuna jetojnë 739,729 banorë ose 46% e popullsisë.⁴ Këto komuna janë njëherit edhe përfituese të mbështetjes në aktivitete të ndryshme nga Helvetas (DEMOS) gjatë vitit 2025, mbështetje kjo që e kanë siguruar nga viti 2018. Po ashtu, përzgjedhja e këtyre komunave është bërë për shkak të bashkëpunimit mes DEMOS dhe komunave lidhur me aktivitetin «kontrata sociale» si dhe kritere shtesë në përzgjedhjen e tyre kanë qenë edhe madhësia e komunave sipas dimensionit demografik dhe atij gjeografik, si dhe numri i vendbanimeve në të cilat jeton një numër ose përqindje e konsiderueshme e komunitetit jo shumicë.

1.1 Specifikat dhe fushat e premtimeve zgjedhore dhe Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK), i bazuar në tregues, ka disa qëllime kryesore. Ky sistem synon matjen e objektivave të cilësisë së shërbimeve që ofrohen nga komunat, mundëson krahasimin e performancës midis komunave të ndryshme me kompetenca të njejta, identifikon fushat që kërkojnë përmirësim në ofrimin e shërbimeve, si dhe krijon një kujtesë institucionale lidhur me ecurinë e punës së komunave. Ky është një proces i detyrueshëm, i bazuar në ligj dhe ka mekanizma të ndërtuara që merren me menaxhimin, vlerësimin dhe raportimin e të dhënave.

Në anën tjetër, kandidatët për kryetarë të komunave nuk obligohen ligjërisht të japin premtime zgjedhore. Premtimet janë një zgjedhje e lirë e kandidatëve se në cilat fusha, projekte ose probleme dëshirojnë të fokusohen. Për më shumë, nuk ekziston monitorim institucional për të vlerësuar nëse premtimet e dhëna po përmbushen apo jo. Pavarësisht nga kjo, të dy këto procese, edhe pse të ndara, tregojnë për karakterin e qeverisjes dhe rezultatet që ajo prodhon.

SMPK zbatohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim të ngushtë me komunat, duke përfshirë zyrtarët përgjegjës për raportim, koordinatoret e performancës dhe kryetarët e komunave, të cilët janë autoritetet përfundimtare për konfirmimin e të dhënave të raportuara. Raportimi dhe vlerësimi bëhet bazuar në Ligjin e performancës së komunave dhe

⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive familjare dhe Banesave. 2024. Fq 54. [Kapitulli i katërt.](#)

skemën e grantit të bazuar në performancë.⁵ Kjo rrjedh nga kompetencat që kanë komunat bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, ku specifikohen qartë përgjegjësitë e komunave në fusha të ndryshme, duke filluar nga shërbimet publike bazike, infrastruktura lokale, mirëmbajtja e hapësirave publike, ndriçimi rrugor, zhvillimi ekonomik lokal, planifikimi urban dhe rural, menaxhimi i tokës dhe ndërtimit, furnizimi me ujë, kanalizimi, mbrojtja mjedisore, menaxhimi i mbeturinave, arsimiti parauniversitar, kujdesi shëndetësor parësor, shërbimet sociale, aktivitetet kulturore, si dhe aspekte të tjera të përcaktuara me ligj.

Aktualisht, SMPK mat performancën në 16 fusha të ndryshme të kompetencave komunale, duke përdorur 94 tregues specifikë. Këta tregues pasqyrojnë numrin e shërbimeve që komunat ofrojnë për qytetarët, bazuar në kompetencat e tyre ligjore. Treguesit ofrojnë një pasqyrë të detajuar të cilësisë së shërbimeve, ndërsa rezultatet ndihmojnë udhëheqësit komunalë në identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim.

Deri në vitin 2021, procesi i raportimit të performancës është menaxhuar në mënyrë manuale përmes postës elektronike, kurse tani zbatohet një sistem elektronik i menaxhimit të performancës, i cili u mundëson qasje të gjithë zyrtarëve raportues të komunave dhe MAPL-së.⁶ Digjitalizimi ka përmirësuar ndjeshëm komunikimin ndër-institucional, ka rritur transparencën e procesit dhe ka mundësuar ruajtjen e të gjitha të dhënave dhe dokumenteve mbështetëse.

Nga ana tjetër, granti i performancës komunale (GPK) paraqet një instrument financiar në sistemin e qeverisjes lokale që rrjedh nga sistemi i performancës komunale. Ky mekanizëm ka ndihmuar komunat të përmirësojnë performancën e tyre në qeverisjen demokratike, menaxhimin financiar dhe ofrimin e shërbimeve.

Për të përfituar nga Granti i Performancës Komunale, komunat e Kosovës duhet të përmbushin katër kushte minimale:

- Raportimi i të dhënave në SMPK brenda afateve të përcaktuara sipas udhëzimeve përkatëse ligjore
- Rishqyrtimi i akteve të tyre që janë vlerësuar si të kundërligjshme nga autoritetet mbikëqyrëse
- Pranimi i së paku një opinionit të pamodifikuar me theksim të çështjes në auditim, dhe
- Shpenzimi i të paktën 75% të buxhetit të tyre final për investime kapitale.

Përveç këtyre kushteve minimale, performanca e komunave vlerësohet në disa fusha, duke përfshirë 94 tregues në fushat si shërbimet publike administrative, transparencën komunale, përgjegjshmërinë komunale, barazinë në punësim, shërbimet sociale dhe familjare, kulturën, rininë dhe sportin, menaxhimin e fatkeqësive, planifikimin hapësinor, infrastrukturën rrugore, ujin e pijshëm, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e mjedisit, arsimin parauniversitar, kujdesin primar shëndetësor dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Ndikimi i GPK-së në qeverisjen komunale është shumëdimensional. Në aspektin financiar, komunat janë bërë më të përgjegjshme në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit dhe përpjekjen për të pasur performancë më të mirë në raportet e auditimit. Kjo ka çuar në një menaxhim më efikas të burimeve publike dhe në rritjen e transparencës së shpenzimeve komunale. Po ashtu, GPK ka nxitur konkurrueshmëri të qeverisjes. Komunat tani fokusohen më shumë në rezultate konkrete dhe angazhohen që të rangohen mirë në listën e përfituesve.


5 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë.](#)

6 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Raporti i Performances së komunave për vitin 2021. [Metodologjia.](#) Fq 6.

Vlera e GPK-së për vitin 2025 ishte 7.7 milionë euro. Katër kushtet minimale për performancën e vitit 2023 i kanë përmbushur komunat e Suharekës, Prizrenit, Mitrovicës së Jugut, Mamushës, Lipjanit, Klinës, Kaçanikut, Junikut, Istogut, Drenasit dhe Dragashit.

Figura 1. Figura nr.1: Komunat që kanë përfituar grant të performancës për vitin 2025


Burim: MAPL Alokimi i grantit për komuna për vitin 2025 bazur në performancës komunale për vitin 2023



Premtimet zgjedhore janë proces i ndarë nga sistemi i menaxhimit të performancës komunale dhe burimin e kanë në aktivitetet zgjedhore që zhvillojnë subjektet politike dhe kandidatët e tyre që garojnë për të marrë pozitën e kryetarëve të komunave. Premtimet bazohen në programe përkatëse zgjedhore, në diskutime mediale apo elektorale në lidhje me tematikat ose problematikat me të cilat përballen komunat apo zonat e veçanta të saj dhe po ashtu një numër i premtimeve zgjedhore burimin e kanë edhe në aktivitetet ditore që zhvillojnë këto subjekte apo këta kandidatë në terren, duke bashkëbiseduar me qytetarë, organizata apo shoqata të ndryshme.⁷

Figura 2. Figura 2: Numri i përgjithshëm i premtimeve zgjedhore të dhëna nga kryetarët e komunave për mandatet: 2013–2017, 2017–2021 dhe 2021–2025

Burimi: Instituti GAP. Platforma "Letërnjoftimi i Komunave".



⁷ Premtimet zgjedhore evidentohen nga ana e Institutit GAP dhe të njëjtat publikohen në platformën e Institutit - [Letërnjoftimi i Komunave](#).


Rritja e vazhdueshme e numrit të premtimeve zgjedhore mund t'i atribuohet disa faktorëve kyç. Digjitalizimi dhe përdorimi i shtuar i mediave sociale ka krijuar hapësirë më të gjerë për komunikim me votuesit, duke i shtyrë kandidatët të artikulojnë më shumë premtime specifike. Pastaj, rritja e vetëdijes qytetare dhe kërkesa për më shumë transparencë ka rezultuar në presion më të madh ndaj kandidatëve për të ofruar zgjidhje konkrete për probleme të ndryshme komunale. Gjithashtu, konkurrenca më e madhe politike dhe pjesëmarrja e shtuar e kandidatëve të rinj në zgjedhje ka kontribuar në rritjen e numrit të premtimeve. Kandidatët përpiqen të dallojnë veten nga konkurrentët duke ofruar më shumë zgjidhje dhe propozime specifike. Po ashtu, një faktor tjetër i rëndësishëm është edhe rritja e kërkesës që subjektet dhe kandidatët të kenë programe specifike të shkruara dhe të prezantuara. Rëndësi këtu ka edhe rritja e kompleksitetit të sfidave me të cilat përballen komunat qoftë në fushën infrastrukturore, arsimit, shëndetësisë dhe fusha të tjera.

Ndërlidhja e plotë mes treguesve të performancës komunale dhe premtimeve zgjedhore varet nga kompetencat dhe përgjegjësitë që u takojnë komunave në fushat përkatëse, të cilat reflektohen si në treguesit e SMPK, ashtu edhe në premtimet zgjedhore.

Nga vlerësimi i premtimeve zgjedhore të bërë nga Instituti GAP, gjatë mandatit 2021–2025 mbi 98% e premtimeve mund të përmbushen brenda të drejtave dhe kompetencave që i kanë komunat. Ndërsa, 2% janë premtime për të cilat kërkohet bashkëpunim ndërinstucional për përmbushjen e tyre, si [p.sh](#) premtimi për kyçje në autostradë, ose premtimi për krijimin e zonave ekonomike, premtimi për themelimin e ndërmarrjeve publike lokale apo premtimet që lidhen me reforma të kurrikulës shkollore.

Figura 3. Figura 3: Numri i treguesve (gjithsej 94) dhe ndarja sipas fushave (gjithsej 16) në SMPK 2021- 2025


Burimi: SMPK ndarja sipas grupeve (MAPL, Raporti i performancës 2024)



Vlerësuar sipas numrit të treguesve, fusha e arsimit parauniversitar ka numrin më të madh të treguesve me gjithsej 15, pastaj vjen ajo e përfaqësimit gjinor me 11 tregues, ndërsa fushat me më së paku tregues janë kultura, rinia dhe sporti dhe fusha e menaxhimit të fatkeqësive të cilat kanë nga dy tregues.

Figura 4. Figura 4: Numri i premtimeve të dhëna (gjithsej 1,816 premtime) sipas fushave (gjithsej 11) për mandatin 2021–2025

Burimi: Instituti GAP. Platforma "Letërnjoftimi i komunave".



Numri i kryetarëve fitues të zgjedhjeve është i lidhur me numrin e komunave, çka nënkupton që për çdo katër vite 38 kryetarë të komunave marrin mandatin e ri. Në zgjedhjet e tetorit 2021 (për mandatin 2021–2025) kanë garuar 165 kandidatë, ku 158 prej tyre kanë qenë kandidatë të propozuar nga subjektet politike, ndërsa pjesa tjetër kanë garuar nga iniciativa qytetare ose si kandidatë të pavarur.⁸

Gjatë dy mandateve të fundit (2017–2021 dhe 2021–2025), në 11 komuna të Kosovës nuk është regjistruar asnjë premtim zgjedhor nga kandidatët që kanë fituar pozitën e kryetarëve të komunave. Këto komuna janë: Graçanica, Novobërda, Ranillugu, Parteshi, Klllokoti, Shtërpca, Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani, Zubin Potoku dhe Mamusha.⁹ Kjo ka ardhur ngase partitë politike që përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës, nuk kanë zhvilluar fushatë aktive në terren, nuk kanë pasur program të shkruar elektoral dhe as nuk janë përfaqësuar në debate televizive për të shpalosur vizionin e tyre për komunat përkatëse, që nënkupton se në asnjë nga këto komuna nuk ka pasur premtime elektorale.

Në zgjedhjet lokale të vitit 2021, ndryshimi i pushtetit nga një parti në një tjetër ka ndodhur në 12 komuna (Prishtinë, Shtime, Gjilan, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Prizren, Hani i Elezit, Vushtrri, Dragash, Junik, Mamushë dhe Skenderaj). Ndërkohë, në 11 komuna të tjera ka pasur ndryshim të kryetarit të komunës, por partia në pushtet ka mbetur e njëjta si në mandatin e kaluar. Si rezultat, 15 kryetarë komunash nga gjithsej 38 kanë arritur të sigurojnë vazhdimin e mandatit për periudhën 2021–2025.

Përfunduar 11 komunat ku nuk ka pasur fushatë aktive në terren dhe mungesë të premtimeve zgjedhore, 27 kryetarë aktualë të komunave për mandatin 2021–2025 kanë dhënë 1,816 premtime. Fusha me numrin më të lartë të premtimeve është ajo e shërbimeve publike me 385 premtime, e ndjekur nga arsimi me 267 premtime.

Në fushën e kulturës dhe infrastrukturës janë dhënë numër i ngjashëm i premtimeve: 198 premtime në kulturë dhe 199 në infrastrukturë. Ndërsa, në fushën e ekonomisë, gjatë këtij mandati janë dhënë 175 premtime.¹⁰

Për dallim nga mandati 2017–2021 ku në fushën e shëndetësisë kanë qenë 67 premtime, në mandatin e fundit, në këtë fushë janë dhënë 134 premtime. Edhe në fushën e bujqësisë këtë mandat janë dhënë 162 premtime, për dallim nga mandati i kaluar ku në të njëjtën fushë kanë

⁸ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Zgjedhjet lokale 2021. [Lista e kandidatëve.](#)

⁹ Instituti GAP. [Letërnjoftimi i Komunave.](#)


¹⁰ Ibid.

qenë 51 premtime. Fusha në të cilen janë dhënë më së paku premtime është ajo e urbanizmit, ku janë të listuara vetëm 41 premtime.

Duke i analizuar premtimet sipas kryetarëve të komunave, numrin më të madh të premtimeve e ka dhënë Kryetari i Prishtinës me 206 premtime, pastaj i Mitrovicës me 123 premtime, i Gjilanit me 109 premtime, i Shtimes me 107 premtime, i Kaçanikut me 94 premtime e kështu me radhë. Kryetari i Vitisë ka dhënë numrin më të vogël të premtimeve për këtë mandat, vetëm 19, për dallim me mandatin e kaluar, kur ai kishte numrin më të madh të premtimeve.¹¹

Figura 5. Figura nr.5: Shpërndarja e premtimeve zgjedhore sipas subjekteve politike që i udhëheqin komunat përkatëse për mandatin 2021–2025


Burimi: Instituti GAP. Platforma "Letërnjoftimi i Komunave".



Kandidatët e subjektit politik Vetëvendosje kanë fituar udhëheqjen në katër komuna (Kamenicë, Gjilan, Shtime dhe Podujevë), Partia Demokratike e Kosovës në tetë komuna (Mitrovicë e Jugut, Skenderaj, Drenas, Vushtrri, Ferizaj, Kaçanik, Hani i Elezit dhe Prizren), Lidhja Demokratike e Kosovës në nëntë komuna (Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Istog, Junik, Pejë, Viti dhe Dragash), dhe Nisma Socialdemokratike në një komunë (Malisheva).

Figura 6. Figura nr.6: Shpërndarja e premtimeve zgjedhore sipas komunave që fokuson raportin

Sqarim: Në komunën e Graçanicës nuk është evidentuar asnjë premtim zgjedhor.



Nga 27 komunat që Instituti GAP vlerëson në aspektin e premtimeve zgjedhore, 15 prej tyre (pjesë e analizës në këtë raport, përjashtuar Graçanicën për shkak të mungesës së premtimeve zgjedhore) janë të evidentuara me 800 premtime zgjedhore, nga 1,816 premtime sa janë gjithsej. Ndër këto 15 komuna, numrin më të madh të premtimeve e kanë dhënë komunat e Kaçanikut, Rahovecit dhe e Prizrenit, ndërsa numrin më të vogël e kanë komunat e Vitisë, Pejës dhe Junikut.

Vlerësuar sipas fushave në këto 15 komuna (përjashtuar Graçanicën), numri më i madh i premtimeve është dhënë në fushën e shërbimeve publike, pastaj vjen arsimi, bujqësia, ekonomia dhe e pesta renditet infrastruktura.


Sipas Institutit GAP, vlerësimi "Nuk kanë filluar" i referohet premtimeve që janë bërë nga kryetarët e komunave, por ende nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret për realizimin e tyre. Instituti GAP nuk merret me analizimin e arsyeve se pse një premtim nuk ka filluar të realizohet ende, ngase vlerësimi bëhet vetëm nëse po realizohet ose jo. Ndërsa, pjesa e premtimeve "Të filluara", përdoret për ato premtime ku, në varësi të fushës dhe natyrës së premtimit, është ndërmarrë një veprim konkret, por ende jo i mjaftueshëm për përmbushjen e plotë të tij. Shembuj të premtimeve të tilla përfshijnë lidhjen e kontratës për kryerjen e punëve, fillimin e punës në terren, shpalljen e thirrjes për ndarjen e bursave ose subvencioneve, ose krijimin e grupit punues për adresimin e ndonjë tematike ose problematike. Po ashtu, si "Të filluara" vlerësohen aktet juridike/administrative, dinamika e të cilave nuk e ka kaluar nivelin e draftit ose konsultimit publik.

Bazuar në të dhënat e Institutit GAP, nga 14 komunat e përfshira e të paraqitura në Figurën 7, rezulton se numri më i madh i premtimeve që mbajnë vlerësimin "Nuk kanë filluar" u takojnë premtimeve si: ndërtimi ose zgjerimi i ujësjellësit dhe kanalizimit, ndërtimi i objekteve të reja shkollore, i qendrave mjekësore, krijimi i parqeve të reja, ndërtimi i impianteve ose inkubatorëve për trajtimin e ujërave të zeza, krijimi i zonave ekonomike ose parqeve industriale, reformimi i administratës dhe premtimet që janë në fushën e urbanizimit si hartimi dhe miratimi i planeve rregulluese, finalizimi i hartës zonale, fuqizimi dhe zgjerimi i procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje e deri te premtimet për hartimin e planeve dhe strategjive sektoriale që për qëllim kanë çështjet hapësinore ose mjedisore.

Ndërsa natyra e premtimeve "Të filluara" zakonisht përfshijnë investime në zonat e trashëgimisë kulturore (ose restaurimi i objekteve), investime ose ndryshime në transportin publik, rritja e rolit të gruas në vendimarrje ose mbështetje e veçantë për gratë ndërmarrëse, projektet që lidhen me digjitalizim ose krijim të platformave elektronike, si dhe premtimet ku dinamika e tyre nuk është e kënaqshme ose punët janë në fazën e parë.

Figura 7. Figura nr.7: Numri i premtimeve që mbajnë vlerësimin "nuk kanë filluar" dhe atyre që mbajnë vlerësimin "i filluar" në 14 komunat e përfshira në këtë raport

Burimi: Instituti GAP – Platforma "Leternjoftimi i komunave".



Sqarim: Përditësimi i fundit në platformën e Institutit GAP "Leternjoftimi i komunave" është bërë me datë 30 qershor 2024.

Tabela 1. Tabela nr.1: Lidhja e fushave në mes të premtimeve zgjedhore dhe fushave në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale

Fushat e treguesve në SMPK	Fushat e premtimeve zgjedhore të cilat lidhen me fushat në SMPK
Shërbime administrative	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Administratë"
Transparencë komunale	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Administratë"
Përgjegjshmëria komunale	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Administratë"
Barazi në punësim, sociale dhe familjare	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet pjesa e sociale dhe familjare futen në kategorin "Sociale", ndërsa punësimi në kategorin "Ekonomi".
Kulturë, Rini dhe Sport	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Kulturë".
Menaxhim i fatkeqësive	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Shërbime Publike"
Planifikim hapësinor	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Urbanizëm"
Hapësira publike	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Shërbime Publike"
Infrastrukturë rrugore	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Infrastrukturë"
Transport publik	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Shërbime Publike"
Shërbime publike	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Shërbime Publike"
Mbrojtje e mjedisit	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Shërbime Publike"
Përfaqësim gjinor	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Administratë"
Arsim parauniversitar	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Arsim"
Kujdes parësor shëndetësor	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Shëndetësi"
Zhvillim ekonomik lokal	Të premtimet zgjedhore kjo kategorizohet "Ekonomi"

Nga vlerësimi i tabelës së mësipërme mund të vërejmë se fushat e premtimeve zgjedhore dhe fushat e SMPK-së kanë një lidhje komplekse dhe jo gjithmonë të njëtrajshme. Disa fusha të SMPK-së ndërlidhen drejtpërdrejtë me fushat e premtimeve zgjedhore, ndërsa të tjerat integrohen në kategori më të gjera.

Lidhja mes fushave nuk nënkupton domosdoshmërisht edhe lidhje në të njejtën fushë me treguesit ose premtimet që ka ajo fushë. Si shembull, në SMPK ekziston fusha "Shërbime administrative", kurse te premtimet zgjedhore kjo evidentohet si "Administratë", ndonëse fushat përkojnë me njëra tjetrën, treguesit dhe premtimet në pjesën më të madhe të rasteve nuk ndërlidhen. Të SMPK janë treguesit si kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit ose kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore, përderisa te premtimet zgjedhore janë premtimet si rritja e numrit të inspektorëve komunal, themelimi i drejtorive të reja, reforma në administratë, eliminimi i burokracive etj.

Si fusha që ndërlidhen mes SMPK dhe premtimeve janë administrata, kultura, infrastruktura, shërbimet publike, arsimi parauniversitar, shëndetësia dhe ekonomia.

Nga ana tjetër, një numër i konsiderueshëm i fushave të SMPK-së, te pjesa e premtimeve zgjedhore integrohen në fushën e shërbimeve publike. Këtu përfshihen mbrojtja e mjedisit, menaxhimi i mbeturinave, kanalizimi, uji i pijshëm, parkingjet publike, transporti publik, hapësirat publike dhe menaxhimi i fatkeqësive. Kjo tregon se shërbimet publike përbëjnë një kategori të gjerë te pjesa e premtimeve zgjedhore. Një grup tjetër i fushave të SMPK-së, përfshirë përfaqësimin gjinor, përgjegjshmërinë komunale, transparencën komunale dhe shërbimet administrative, integrohen në fushën e administratës në premtimet zgjedhore. Kjo strukturë e ndërlidhjes tregon se ndërsa SMPK-ja ka një ndarje më të detajuar dhe specifike të fushave, premtimet zgjedhore i grupojnë këto fusha në kategori më të gjera dhe më gjithëpërfshirëse.

1.2 A ndërlidhen premtimet zgjedhore me treguesit e performancës komunale?

Nga krahasimi dhe vlerësimi i 14 komunave, pjesë të këtij raporti, rezulton se nga 800 premtime, 166 prej tyre apo 21% e tyre kanë lidhje të plotë ose të pjesshme me treguesit e SMPK, ndërsa 634 premtime apo 79% e tyre nuk ndërlidhen në asnjë formë me treguesit e sistemit të menaxhimit të performancës komunale.

Tri komunitat që kanë lidhjen më të mirë mes premtimeve dhe SMPK janë: Prizreni me 33%, Obiliqi dhe Suhareka me mbi 25%. Ndërsa tri komunitat që kanë lidhjen më të ulët mes premtimeve dhe SMPK janë: Vitia me vetëm 6.3%, si dhe Klina dhe Drenasi me 15%.

Lidhja mes premtimeve dhe treguesve dhe ndikimi i tyre te granti i performancës, jep rezultate të ndryshme te komunitat e ndryshme. Kësisoj, ndonëse Drenasi rangohet në mesin e komunave me shkallë të ulët të lidhjeve mes premtimeve dhe treguesve, kjo komunë ka dëshmuar vazhdimisht rezultate të larta në performancën komunale, duke u renditur në vend të parë në vitet 2019, 2020 dhe 2023.¹²

Nga ana tjetër, Prizreni ka treguar një lidhje më të lartë mes premtimeve zgjedhore dhe treguesve të SMPK. Në këtë periudhë, Prizreni është ranguar më lartë në Grantin e Performancës Komunale (GPK), duke sugjeruar se menaxhimi efektiv komunal dhe përmbushja e premtimeve zgjedhore janë faktorë kyç për sigurimin e fondeve shtesë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunave.¹³

Komunitat që janë pjesë e këtij raporti me numrin më të madh të premtimeve të dhëna janë Kaçaniku me 94 premtime, Rahoveci me 84, Prizreni me 78, Suhareka me 78, ndërsa komunitat me numrin më të vogël të premtimeve janë Vitia me 19, Peja me 25 dhe Dragashi me 32 premtime.

Kësisoj, niveli i ndërlidhjes së premtimeve me treguesit e SMPK në secilën komunë është si vijon:

- Në Komunën e Drenasit, premtimet e dhëna përputhen me 15% të treguesve të SMPK. Më konkretisht, nga 37 premtime sa ka kjo komunë për mandatin 2021–2025, 5 përputhen plotësisht me SMPK, 9 përputhen pjesërisht, ndërsa 23 nuk përputhen fare.
- Në Komunën e Pejës, premtimet e dhëna përputhen me 16% të treguesve të SMPK. Më konkretisht, nga 25 premtime sa ka kjo komunë për mandatin 2021–2025, 10 përputhen plotësisht me SMPK, 5 përputhen pjesërisht, ndërsa 10 nuk përputhen.
- Në Komunën e Obiliqit, premtimet e dhëna përputhen me 25.5% të treguesve të SMPK. Përkatësisht, nga 69 premtime, 5 përputhen plotësisht, 19 pjesërisht dhe 45 nuk gjejnë asnjë përputhje me SMPK.
- Në Komunën e Rahovecit, premtimet e dhëna përputhen me 17% të treguesve të SMPK. Konkretisht, nga 84 premtime, 13 kanë lidhje të plotë, 3 kanë lidhje të pjesshme dhe 68 nuk gjejnë asnjë lidhje me SMPK.
- Në Komunën e Vitisë, premtimet e dhëna përputhen me 6.3% të treguesve të SMPK. Në këtë komunë janë dhënë 19 premtime, prej të cilave 3 përputhen plotësisht, 3 të tjera pjesërisht, ndërsa 13 nuk përputhen.
- Në Komunën e Junikut, premtimet e dhëna përputhen me 21% të treguesve të SMPK. Nga 35 premtime, 5 kanë lidhje të plotë, 15 të pjesshme, ndërsa 15 nuk përputhen.
- Në Komunën e Ferizajt, premtimet e dhëna përputhen me 17% të treguesve të SMPK. Përkatësisht, nga 69 premtime, 6 përputhen plotësisht, 10 pjesërisht, ndërsa 53 nuk përputhen.
- Në Komunën e Podujevës, premtimet e dhëna përputhen me 23% të treguesve të SMPK. Konkretisht, nga 61 premtime, 11 përputhen plotësisht, 11 të tjera pjesërisht, ndërsa 39 nuk përputhen.

¹² Koha.net. [Drenasit e para në performancë](#). 16 shtator 2020.

¹³ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Raporti i ndarjes se grantit të performancës për vitin 2025, vlerësuar për vitin 2023.

- Në Komunën e Prizrenit, premtimet e dhëna përputhen me 33% të treguesve të SMPK. Përkatësisht, nga 78 premtime, 16 kanë lidhje të plotë, 15 kanë lidhje të pjesshme, ndërsa 47 premtime nuk përputhen.
- Në Komunën e Dragashit, premtimet e dhëna përputhen me 17% të treguesve të SMPK . Konkretisht, nga 32 premtime, 7 kanë lidhje të plotë, 9 kanë lidhje të pjesshme, ndërsa 16 nuk ndërlidhen me SMPK.
- Në Komunën e Klinës, premtimet e dhëna përputhen me 15% të treguesve të SMPK. Përkatësisht, nga 63 premtime, 6 përputhen plotësisht, 8 përputhen pjesërisht, ndërsa 49 premtime nuk përputhen.
- Në Komunën e Suharekës, premtimet e dhëna përputhen me 25.5% të treguesve të SMPK. Nga 77 premtime sa ka kjo komunë gjithsej, 6 përputhen plotësisht, 18 kanë lidhje të pjesshme, ndërsa 53 nuk gjejnë asnjë ndërlidhen me SMPK.
- Në Komunën e Kamenicës, premtimet e dhëna përputhen me 20% të treguesve të SMPK. Nga 56 premtime, 4 kanë lidhje të plotë, 15 kanë lidhje të pjesshme, ndërsa 35 nuk përputhen.
- Edhe në Komunën e Kaçanikut, premtimet e dhëna përputhen me 20% të treguesve të SMPK. Përkatësisht, nga 94 premtime, 12 gjejnë përputhje të plotë, 7 të pjesshme, ndërsa 75 nuk gjejnë asnjë përputhje.

Tabela 2. Tabela nr.2: Paraqitja e lidhjes mes premtimeve zgjedhore dhe treguesve në SMPK sipas komunave

✘ – nuk ekziston lidhja mes ndonjë premtimi dhe treguesit specifik në SMPK

● – ekziston lidhje e plotë mes ndonjë premtimi dhe treguesit specifik në SMPK

◐ – ekziston lidhje e pjesshme mes ndonjë premtimi dhe treguesit specifik në SMPK

Treguesit e SMPK

Komunat

	Drenas	Kaçanik	Pejë	Kamenicë	Obiliq	Suharekë	Rahovec	Klinë	Viti	Dragash	Junik	Ferizaj	Podujevë	Prizren
Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	✘	✘	✘	●	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	✘	✘	✘	◐	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	◐	✘	✘
Shërbimet administrative në mënyrë elektronike nga komuna	●	✘	✘	◐	◐	●	●	✘	✘	●	✘	◐	◐	◐
Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	◐	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Adresimi i kërkesave të qytetarëve në takimet për buxhet	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Aktet komunale dhe dokumentet të konsultuara me publikun	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Dëgjime publike për KAB, buxhet komunal dhe buxhetimi me pjesëmarrje	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	◐	✘	●

Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	●
Funksionimi i këshillave lokal	●	×	×	◐	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×
Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	◐	×	●
Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	●
Diskutim për raportin e performancës komunale nga Kuvendi Komunal	×	×	×	◐	×	×	×	×	×	×	×	×	×	●
Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×
Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditori i brendshëm	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×
Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×
Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	×	×	×	◐	×	×	×	×	×	×	×	×	×	●
Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	●
Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×
Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×
Përgatitja e planit për zhvillimin e personelit	×	×	×	◐	×	◐	×	×	×	●	×	×	×	◐
Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×
Zyrtarë Publik të punësuar nga komunitetet jo-shumicë	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×
Familjet me nevojë të cilëve iu është siguruar banimi social	×	◐	×	×	◐	◐	×	×	×	×	×	×	◐	◐
Fëmijët me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar	×	×	×	◐	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×
Programi trevjeçar komunal i banimit social	×	×	×	×	◐	◐	×	×	×	×	×	×	×	×
Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve	●	◐	◐	×	×	◐	●	◐	×	×	×	×	●	◐
Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal	●	●	×	×	◐	◐	×	◐	×	×	×	×	●	◐
Niveli i realizimit të planit komunal për Reagim Emergjent	×	●	×	×	×	◐	×	◐	×	×	×	×	×	×
Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	×	×	×	×	×	◐	●	×	×	×	×	×	×	×
Sipërfaqja e territorit të komunave të mbuluar sipas planeve zhvillimore	×	×	●	×	×	◐	●	×	×	◐	×	×	×	◐
Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	×	×	×	×	◐	×	◐	×	×	×	×	×	×	×
Objekte të inspektuara me leje të ndërtimit	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×	×

Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra në m ² publike për kokë banori	✗	●	✗	✗	◐	◐	●	●	◐	◐	◐	◐	●	◐
Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	✗	✗	✗	✗	◐	✗	✗	✗	✗	✗	◐	◐	✗	✗
Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	◐	●	●	✗	✗	◐	●	●	✗	●	◐	◐	●	◐
Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	✗	✗	●	✗	◐	◐	✗	●	◐	●	◐	✗	●	◐
Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	◐	●	●	✗	◐	◐	●	●	◐	✗	◐	●	✗	✗
Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjzim vertikal dhe horizontal	✗	●	✗	✗	✗	✗	●	✗	●	●	✗	✗	✗	✗
Rrugët me shteg të biçikletave	✗	●	✗	◐	✗	◐	●	●	●	●	●	●	●	●
Rrugët lokale të riasfaltuara	●	●	●	◐	◐	◐	✗	●	●	●	●	●	●	✗
Realizimi i planit komunal për transport lokal publik	✗	◐	✗	◐	●	✗	✗	✗	✗	✗	◐	✗	◐	●
Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	✗	✗	✗	◐	●	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	●
Vendndalimet e shënjuara për automjetet e transportit publik	✗	✗	✗	✗	●	✗	◐	✗	✗	✗	✗	✗	✗	●
Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit	◐	✗	◐	✗	◐	◐	✗	✗	✗	◐	✗	◐	◐	◐
Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	◐	✗	◐	✗	◐	◐	✗	✗	✗	✗	◐	◐	◐	◐
Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	✗	●	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	◐	✗	◐	✗	◐
Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	◐	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Lejet mjedisore komunale të lëshuara	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Gratë e punësuar në institucione/ administratën komunale	◐	✗	●	✗	◐	✗	✗	✗	✗	✗	●	✗	✗	◐
Gratë në pozita udhëheqëse në institucione	✗	✗	●	●	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	✗	✗	✗	●	✗	✗	✗	✗	✗	✗	●	✗	✗	✗
Barazia gjinore tek emërtimet e rrugëve	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗

Çerdhe dhe kopshte publike në zona rurale për 10000 banorë	✘	◐	✘	✘	◐	✘	◐	◐	✘	✘	◐	●	◐	◐
Metër katror të hapësirave shkollore për kokë nxënësi	✘	●	◐	◐	◐	◐	✘	✘	✘	◐	◐	●	●	◐
Shkollat e pajisura me kabinet të TIK	◐	●	✘	◐	✘	●	✘	✘	✘	✘	◐	●	●	✘
Shkollat me masa të eficiencës së energjisë	✘	✘	✘	✘	✘	✘	●	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	✘	●	✘	✘	◐	✘	✘	✘	✘	✘	◐	✘	●	◐
Plotësimi i kushteve me infrastrukturë në institucionet arsimore	◐	✘	◐	✘	●	●	●	◐	✘	✘	◐	✘	●	●
Mësimdhënësit që i plotësojnë kriteret e kualifikimit të licencuar	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Shkalla bruto e regjistrimit në kl.1	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Shkalla e qasjes – tranzicioni kl.9-kl.10	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Rezultatet e testit të arritshmërisë për kl.9	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Braktisja e shkollës nga nxënësit	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Meter katror të hapësirave KPS për 10000 banorë	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Objektet e KPS të pajisura sipas udhëzimit administrativ	✘	✘	●	✘	◐	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Niveli i raportit mjek familjar-infermier për banorë	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Përqindja e buxhetit për kujdes parësor shëndetësor	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Numri i vizitave të pacientëve në KPS për kokë banori	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Fëmijët e përfshirë në programin e imunizimit	✘	◐	✘	●	◐	●	✘	✘	✘	◐	◐	✘	◐	●
Ofrimi i kujdesit shëndetësor specialistik për gra dhe fëmijë	◐	✘	✘	◐	✘	✘	✘	✘	✘	◐	◐	✘	◐	✘
Plani për zhvillim ekonomik lokal	✘	✘	✘	✘	●	●	●	✘	✘	◐	●	✘	◐	●
Përgatitja e listës së pronave komunale për dhënie në shfrytëzim	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Niveli i azhurnimit të regjistrimit të tatimit në pronë	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Vendparkimet për mjete motorike në territorin e komunës	✘	✘	◐	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	◐	●
Vendparkimet e destinuar për taksì	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘
Numri i parkingjeve për persona me aftësi të kufizuar	✘	✘	✘	✘	✘	◐	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘	✘

Vendbanimet e përfshira në sistemin për trajtim të ujërave të zeza	✗	●	●	●	✗	●	●	●	✗	●	●	✗	●	●
Ekonomitë familjare me qasje në grumbullimit të mbeturinave	✗	●	✗	✗	✗	✗	✗	●	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Pjesëmarrja e grave në konsultime publike	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Plani komunal për barazi gjinore	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Ndërmarrja e masave për uljen/thjeshtëzimin e barrës administrative	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗

Burimi: Treguesit e SMPK dhe premtimet zgjedhore "Letërnjoftimi i Komunave" GAP.

Treguesi i SMPK "Rrugët me shteg të biçikletave" haset plotësisht në nëntë nga 14 komuna, kurse "Rrugët lokale të riasfaltuara" haset në tetë plotësisht nga 14 komuna, dhe "Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik" haset në pesë komuna. Kurse treguesi "Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra në m² publike për kokë banori" haset në tetë komuna. Pastaj, "Vendbanimet e përfshira në sistemin për trajtim të ujërave të zeza" haset në shtatë komuna. Po ashtu, "Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit" haset në shtatë komuna.

Për 35 tregues, nga 94 gjithsej, nuk haset asnjë premtim zgjedhor në 14 komunat e analizuar, përfshirë këtu: pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultime publike, adresimin e kërkesave të qytetarëve në takimet për buxhet, aktet komunale dhe dokumentet e konsultuara me publikun, publikimin e raporteve për procese të konsultimeve publike, diskutimin e raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit, nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga auditori i brendshëm, nivelin e pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, të punësuarit me nevoja të veçanta në institucione komunale, zyrtarët publikë të punësuar nga komunitetet jo-shumicë, objekte të inspektuara me leje të ndërtimit, rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës, rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit, realizimin e orarit për mbledhjen e mbeturinave, inkasimin e mjeteve për mbledhjen e mbeturinave, treguesit e tatimit në pronë, barazia gjinore në emërtime të rrugëve dhe komitete komunale dhe shumicën e treguesve të shëndetësisë.

Mungesa e këtyre treguesve në premtimet zgjedhore mund të shpjegohet përmes katër faktorëve:

1. Shumica e këtyre treguesve lidhen me procese administrative dhe teknike të menaxhimit komunal, të cilat nuk konsiderohen si "tërheqëse" nga perspektiva e fushatës zgjedhore. Kandidatët zakonisht preferojnë të fokusohen në premtime më të prekshme dhe të dukshme si ndërtimi i rrugëve të reja ose hapja e shkollave, në vend të proceseve të brendshme administrative.
2. Këta tregues shpesh kërkojnë reforma afatgjata dhe strukturore, të cilat është e vështirë t'i prezantohen publikut në formën e premtimeve të shpejta zgjedhore. Për shembull, përmirësimi i proceseve të konsultimit publik ose rritja e transparencës në menaxhimin financiar janë procese komplekse që kërkojnë kohë dhe përpjekje të vazhdueshme dhe nuk duken thelbësore që mund të tërheqin votën e qytetarëve.
3. Fakti se çështjet sociale si barazia gjinore dhe punësimi i personave me nevoja të veçanta

nuk trajtohen me prioritet gjatë fushatave në krahasim me fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike.

4. Treguesit që lidhen me menaxhimin e brendshëm financiar dhe auditimin, ndonëse janë thelbësore për funksionimin efektiv të komunës, neglizhohen në premtimet zgjedhore pasi konsiderohen si çështje të "brendshme" dhe jo tema që i adresojnë nevojat praktike të qytetarëve.

Nga 94 treguesit e SMPK-së, gjashtë prej tyre kanë lidhje të fortë me pjesën dërrmuese të premtimeve zgjedhore në 14 komunat e përfshira në këtë raport. Treguesit me shkallën më të lartë të lidhjes me premtime janë: hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik, rrugët me shtigje për biçikleta, rrugët lokale të riasfaltuara, plani për zhvillim ekonomik lokal, përmirësimi i kushteve në sistemin arsimor parauniversitar, vendbanime të përfshira në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza, si dhe treguesi i plotësimit të kushteve infrastrukturore në institucionet arsimore.

Për të vlerësuar përputhshmërinë ose jo mes rezultateve në SMPK dhe vlerësimit të premtimeve zgjedhore nga Instituti GAP, më poshtë do të jepet një pasqyrë e kësaj lidhjeje në tre treguesit e SMPK që kanë rezultuar të kenë shtrirje të numri më i madh i komunave që përfshin ky raport.

Treguesi "Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik" është hasur plotësisht në përputhje me premtimet që janë dhënë në Kaçanik, Rahovec, Viti, Klinë, Junik dhe Podujevë. Rezultatet që këto komuna kanë shënuar në këtë tregues gjatë viteve 2022 dhe 2023, janë: nga 100 pikë sa është niveli më i lartë, Kaçaniku në 2022 ka pasur 67.70, ndërsa në 2023 ka pasur 71. Duke iu referuar premtimeve zgjedhore, në rastin e Kaçanikut haset premtimi "Finalizimi i rrugëve primare të komunës me ndriçim publik". Në vitin 2022, ky premtim është vlerësuar "Nuk ka filluar", ndërsa në 2023 ka marrë vlerësimin "I filluar". SMPK vlerëson tërësinë e territorit (hapësirave) që mbulohet me ndriçim publik, pavarësisht se kur është instaluar dhe funksionalizuar ndriçimi, ndërsa Instituti GAP vlerëson vetëm projektet dhe investimet nga nisja e mandatit e tutje.

Në vitin 2022, Rahoveci ka pasur vlerësimin prej 39.2 pikë në SMPK, ndërsa në vitin 2023 është vlerësuar me 96.69, pra një rritje prej mbi 57 pikësh krahasuar me një vit më parë. Ky vlerësim në SMPK është përputhur plotësisht edhe me vlerësimin e GAP në vitin 2022, kur ka pasur vlerësimin "I filluar" dhe në 2023 kur ka marrë vlerësimin "I përbushur". Kjo nënkupton se Rahoveci ka arritur të zbatojë ose të investojë në shumë zona në instalimin ose zgjerimin e ndriçimit publik. Te Klina, ky tregues në 2022 dhe 2023 është vlerësuar me 100 pikë, ndërkohë që vlerësimi i premtimit ka qenë "I filluar" në të dy vitet. Kjo ka ardhur për shkak të të njëjtit shpjegim si në rastin e Kaçanikut, ku GAP vlerëson vetëm projektet dhe investimet nga nisja e mandatit e tutje, ndërsa SMPK vlerëson tërësinë e investimeve dhe jo periudhën e tyre.

Kurse, Juniku në 2022 dhe 2023 është vlerësuar me 100 pikë, ndërsa Podujeva në të dy vitet është vlerësuar me më pak se një pikë. Në lidhje me premtimin zgjedhor, Juniku në të dy vitet figuron me vlerësimin "I filluar", ndërsa Podujeva në 2022 ka pasur vlerësimin "Gjysmë i përbushur" dhe në 2023 vlerësimin "I përbushur". Kjo mospërputhje në rastin e Podujevës nxjerr në pah nevojën që vlerësimi në SMPK të jetë më i detajuar dhe më i plotë, pasi në të dhënat e GAP figurojnë dhjetëra rrugë, lagje, fshatra dhe vendbanime që janë përfshirë në sistemin e ndriçimit publik. Për rrjedhojë, vlerësimi me më pak se një pikë në SMPK nuk duket i saktë, që ka mundur të vjen për shkak të mënyrës se si komuna i ka raportuar të dhënat.

Treguesi tjetër, "Rrugët me shtigje për biçikleta," është hasur si premtim në Kaçanik, Rahovec, Klinë, Viti, Junik, Ferizaj, Podujevë dhe Prizren. Kaçaniku në vitin 2022 në këtë tregues ka pasur zero pikë, ndërsa në vitin 2023 niveli i pikëve ka qenë 4.23. Te premtimi zgjedhor i monitoruar nga GAP, në vitin 2022 Kaçaniku ka pasur vlerësimin "I filluar," ndërsa në vitin 2023 ky nivel i vlerësimit është ngritur në "Gjysmë i përbushur." Ky dallim në vlerësim në SMPK dhe te pjesa e premtimit zgjedhor ka ardhur për shkak se te pjesa e premtimit është premtuar shteg për çiklizëm, rregullim i rrugës dhe trotuarit në rrugën "Murat Lika". Nga të dhënat në terren, rruga ka përfunduar dhe trotuari pjesërisht, ndërsa shtegu për çiklizëm është shënjëzuar, por akoma nuk ka filluar puna në terren. Nëse do të merrej për vlerësim të premtimit vetëm

shtegu i çiklizmit, atëherë rezultatet në vlerësim mes SMPK dhe premtimit nuk do të dallonin. Në Rahovec ky tregues në 2022 dhe 2023 në SMPK është vlerësuar me 8.27 pikë, ndërsa te premtimet zgjedhore ka vlerësimin "Gjysmë i përmbushur." Në Klinë, në vitin 2022 ky tregues është vlerësuar me 24.44 pikë, ndërsa në vitin 2023 me më pak se një pikë. Kjo ka mundur të vije për shkak të mënyrës se si komuna i ka raportuar të dhënat. Te premtimet zgjedhore, natyra e këtij treguesi është "Gjysmë i përmbushur" për shkak të evidentimit të zonës përkatëse dhe investimit përkatës të kryer në ndërtimin e shtegut të çiklizmit. Në Viti, ky tregues në SMPK është vlerësuar në vitin 2022 me zero pikë, ndërsa një vit më vonë është vlerësuar me 57.76 pikë. Edhe te premtimet mban vlerësimin "Gjysmë i përmbushur." Në Junik, në SMPK ky tregues është vlerësuar në vitin 2022 me 9.73 pikë, ndërsa në vitin 2023 me 17.71 pikë. Te premtimet zgjedhore, vlerësimi është "Gjysmë i përmbushur." Në Ferizaj, ky tregues në vitin 2023 ka marrë vlerësimin 16.98, ndërsa për vitin 2022 nuk ka të dhëna, ngase kjo komunë ka refuzuar t'i raportojë të dhënat në SMPK. Te premtimet zgjedhore, natyra e këtij treguesi vlerësohet "Gjysmë i përmbushur." Në Podujevë, në vitin 2022 ky tregues ka pasur vlerësimin në SMPK me 1.14 pikë, kurse në vitin 2023 me 3.85 pikë. Te premtimet zgjedhore, vlerësimi është premtim "I përmbushur" për shkak se është evidentuar që në së paku katër rrugë të qytetit, me gjatësi deri në 6 km, janë krijuar shtigjet për biçikleta. Në Prizren, në vitin 2022 është vlerësuar me 27.43 pikë, një vit më vonë me 28.11 pikë, ndërsa te premtimi vlerësimi është "Gjysmë i përmbushur," por ky vlerësim ka ardhur për shkak se natyra e premtimit është më e gjerë sesa vetëm ndërtimi i shtegut për çiklizëm.

Treguesi i radhës "Rrugët lokale të riasfaltuara" është hasur në Drenas, Kaçanik, Pejë, Klinë, Viti, Dragash, Junik, Ferizaj dhe Podujevë. Nisur nga fakti se komunat e tjera ishin të përfshira në treguesit më lartë, këtu do të paraqiten vetëm të dhënat për Drenasin dhe Pejën. Në Drenas, në vitin 2022 dhe 2023 ky tregues në SMPK ka pasur 100 pikë, ndërsa edhe te premtimet zgjedhore natyra e këtyre premtimeve kryesisht ka marrë vlerësimin "I përmbushur". E njëjta qëndron në Kaçanik, si për vlerësimin në SMPK, ashtu edhe për premtimin zgjedhor. Në Pejë, ky tregues, në vitin 2022 ka pasur 73.03 pikë, ndërsa në vitin 2023 është vlerësuar me 53.44 pikë. Sa i përket premtimit zgjedhor të monitoruar nga GAP, vlerësimi është "Gjysmë i përmbushur", që tregon një përputhshmëri të plotë mes vlerësimit të parë dhe këtij të dytë.

Treguesi "Plani për zhvillim ekonomik lokal" është hasur në Obiliq, Rahovec, Junik dhe Prizren. Ky tregues ka qenë në fuqi në vitin 2022, por është larguar gjatë rishikimit të treguesve në SMPK gjatë 2023, kur nga 119 tregues është zbritur në 94 tregues. Në Obiliq, në vitin 2022, është vlerësuar me zero pikë, ndërsa te premtimet, në vitin 2022, është vlerësuar "I filluar" për shkak të themelimit të grupit punues dhe zhvillimit të konsultimeve të para publike. Në Rahovec është vlerësuar në SMPK me 100 pikë, ndërsa të njëjtin vlerësim e ka mbajtur edhe te premtimet me vlerësimin "I përmbushur". I njëjti vlerësim në të dy anët qëndron edhe në Junik. Ndërsa në Prizren, në vitin 2022, vlerësimi në SMPK ka qenë zero pikë, dhe po këtë vlerësim e ka pasur edhe te platforma e komunave e Institutit GAP për premtimet zgjedhore.

Përfundim

Analiza e ndërlidhjes mes premtimeve zgjedhore dhe Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale në 15 komuna të Kosovës ka nxjerrë në pah specifika të rëndësishme që paraqesin njëri dhe tjetra fushë. Nga 800 premtimet e analizuar, vetëm 21% përputhen plotësisht me treguesit e SMPK, ndërsa 79% e premtimeve nuk gjejnë përputhje me treguesit e performancës.

Lidhja mes premtimeve dhe treguesve dhe ndikimi i tyre te granti i performancës, jep rezultate të ndryshme të komunat e ndryshme. Është domethënëse që 35 nga 94 tregues të SMPK-së nuk gjejnë fare reflektim në premtimet zgjedhore. Kjo mungesë është veçanërisht e dukshme në treguesit e proceseve administrative, teknike dhe çështjeve sociale.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti vërehet një mospërputhje strukturore mes asaj që matet në SMPK dhe asaj që premtohet gjatë fushatave zgjedhore. Ndërsa SMPK përqendrohet në aspekte teknike dhe të matshme të performancës komunale, premtimet zgjedhore shpesh orientohen drejt projekteve konkrete për zona, lagje dhe fshatra. Kjo krijon një situatë ku sukcesi i një komune mund të matet ndryshe nga perspektiva e SMPK-së krahasuar me perceptimin publik të përmbushjes së premtimeve.

Për më shumë, ka mekanizma të qartë të matjes dhe vlerësimit, ndërsa premtimet zgjedhore nuk i nënshtrohen një sistemi të standardizuar të monitorimit, përjashtimisht që këtë e bën në formë periodike Instituti GAP që nga viti 2009. Bazuar në rezultatet e SMPK dhe poentimin e treguesve për vitin 2022 dhe 2023 dhe vlerësimet e Institutit GAP për premtimet zgjedhore, shihet se ka një nivel të ndryshueshëm përputhshmërie. Në disa raste, si Rahoveci dhe Drenasi, rezultatet e SMPK dhe vlerësimet e premtimeve përkojnë plotësisht. Ndërkohë, raste si Podujeva dhe Klinë tregojnë mospërputhje të dukshme, e cila mund të vijë si pasojë e mënyrës së raportimit të të dhënave dhe metodologjisë që aplikohet nga MAPL te pjesa e SMPK-së dhe Institutit GAP te pjesa e premtimeve zgjedhore.

Krahasimi mes fushave të performancës dhe premtimeve zgjedhore tregon dallime të rëndësishme në qasje dhe matje. Në fushën sociale, SMPK fokusohet në matjen e punësimit të grupeve të caktuara dhe ofrimin e shërbimeve sociale bazike, ndërsa premtimet zgjedhore janë më ambicioze duke përfshirë ndërtimin e objekteve për shërbime sociale, strehim familjar dhe mbështetje financiare. Në fushën e urbanizmit, SMPK mat kryesisht mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe parqeve, ndërsa premtimet zgjedhore fokusohen më shumë në hartimin e planeve rregulluese, hartave zonale dhe transparencën e lejeve ndërtimore. Kjo tregon një hendek mes asaj që matet dhe asaj që premtohet. Infrastruktura paraqet fushën me përputhshmërinë më të lartë mes dy sistemeve. Si SMPK ashtu edhe premtimet zgjedhore ndjekin të njëjtat parametra: asfaltimin e rrugëve, rregullimin e trotuareve, ndriçimin publik dhe infrastrukturën përcjellëse. Kjo shpjegon edhe numrin më të lartë të premtimeve të realizuara në këtë fushë. E njëjta gjendje është evidentuar edhe në fushat e tjera të ndërlidhura mes SMPK dhe fushave të premtimeve zgjedhore.



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

info@institutigap.org

Ky projekt është mbështetur nga



**Co-funded by
the European Union**




Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



**Sweden
Sverige**

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



Ndërlidhja e premtimeve zgjedhore me
treguesit e performancës komunale
(Analizë në 15 komuna)